



|                                                                                     |                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                             |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                             |
| Dep. <u>2-D/DPK</u>                                                                 | Nr. Prot. <u>01-2675/14</u> |
| Dep. <u>02</u>                                                                      | Br. Prot. <u>18-07-2014</u> |
| Nr. l faq. <u>02</u>                                                                | Data <u>18-07-2014</u>      |
| Broj stranica <u>02</u>                                                             | Date <u>18-07-2014</u>      |
| Nr. pages <u>02</u>                                                                 |                             |
| PRISHTINE                                                                           |                             |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.07.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-2160/14, për z. Arben Kutllovci, u.d. Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-2160/14, që për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Arben Kutllovci, u.d. Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si u.d. Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë, është duke ushtruar edhe funksione tjera në veprimtari private, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 29.05.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Arben Kutllovci, u.d. Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.



Zyrtarët e Agjencisë ne takimin qe është mbajtur me z. Kutillovci, e kanë njoftuar me faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit ne ushtrim te funksionit publik, ndërsa z.Kutillovci është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se ne afat sa me te shpejt do te bej ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit te interesit.

Me datën 12.06.2014, z.Arben Kutillovci, ka sjell në Agjenci dokumentin zyrtar te lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se ne biznesin privat zyrtari ne fjalë ka autorizuar një person tjetër.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

